

Data 13.08.2026

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Zhvillimi i 2 fiderave te rinj C21 dhe C14/1 nga N/Stacioni Traktora, 110/20/6 kV, për uljen e ngarkesave në fiderat C14 me L11 dhe linje e dedikuar për Parlamentin”

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
45231400-9 - Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike

---

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 62,053,332 (gjashtedhjetë e dy milion e pesëdhjetë e tre mijë treqind e tridhjetë e dy) **Lekë pa TVSH.**

---

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

## 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

*Referuar pikes 1 te shtojces 8, ofertuesi duhet te deklaroje se permbush kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit. Keto kriteret duhet te plotesohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, ne ditën e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 8.*

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2023, 2024 dhe 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **...b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.”

Ky kriter siguron që operatorët ekonomikë që marrin pjesë kanë kapacitetin financiar për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë të sigurtë dhe të efektshme. Ky është i rëndësishëm për të shmangur situata ku operatorët nuk plotesojnë kapacitetin financiar dhe nuk mund të përfundojnë projektin.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025**, të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të vulosura nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 i ndryshuar me Ligjin nr. 126/2024 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuar në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja b" të Ligjit nr. 1009/2009 i ndryshuar me Ligjin nr. 126/2024 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar": "Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii.ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025(për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et

sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (**të vitit 2026**) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

\*\*\* Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/et lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në Shtojcën përkatëse të DST.

**Argumentimi:** Ne lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 ”Për Sistemin e Taksave Vendore”, (i Ndryshuar).

Njësia e prokurimit kerkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudit;
  - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
  - Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të **deklaruara në organet tatimore** dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Kontratë Sipërmarrje
  - Situacionin përfundimtar;
  - Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.

- Aktin e kolaudimit;

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, sipas parashikimeve të nenit 88, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, sipas parashikimeve të nenit 88, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat. **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **200%**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përmirësimi i infrastrukturës së linjave TM/TU kërkon një kohë të konsiderueshme për të kryer punët me sukses dhe në përputhje me standardet e nevojshme. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje.

Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur.

Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

**2.3.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi*” të ndryshuar, e cila përfshin kategorite e mëposhtme:

Punime te pergjithshme/speciale ndertimi:

|                 |                                                                                                         |                  |
|-----------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| Kategoria NP-1  | Punime germimi ne toke                                                                                  | Klasifikimi<br>A |
| Kategoria NP-11 | Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë | Klasifikimi<br>C |
| Kategoria NS-8  | Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri                                          | Klasifikimi<br>A |
| Kategoria NS-4  | Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik             | Klasifikimi<br>A |

*Shenim: Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.*

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehesimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet:

*“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”*

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| Kodi                                       | Emertimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Vlera me Tvsh bazuar ne preventiv | Nr.      |
|--------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|----------|
| <b>NP - 1</b>                              | <b>Punime &amp; Germime ne toke</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | <b>8,625,051.41</b>               | <b>A</b> |
| Zerat e punes sipas kategorise se Liçenses | Gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                   |          |
| Zerat e punes sipas preventivit            | 2.15, 2.166, 2.197, 2.197/1, 2.19a, 2.200, 2.206, 2.209, 2.212, 2.294/2, 2.300, 2.310, 2.331, 2.401, 2.404, 2.426/11, 2.426/3, 2.428, 2.451, 2.576/2, 3.45/1, 3.620, 3.653, 4.141/a7.0, 4.174, 4.190, 4.37, An te ndryshme                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                   |          |
| <b>NS - 8</b>                              | <b>Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | <b>2,247,445.43</b>               | <b>A</b> |
| Zerat e punes sipas kategorise se Liçenses | Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri. Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.                                                                                                                                                                                                                                  |                                   |          |
| Zerat e punes sipas preventivit            | 1.81/p, 2.111, 2.262/3, 2.262/4, 2.275, 2.294/1, 2.294/2, 2.426/3, 3.243, 3.244, 4.3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                   |          |
| <b>NP - 11</b>                             | <b>Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | <b>60,039,640.31</b>              | <b>C</b> |
| Zerat e punes sipas kategorise se Liçenses | Ndërtime për nënstatione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore. |                                   |          |
| Zerat e punes sipas preventivit            | 2.461, 2.481/1, 2.485/1, 2.487/a, 2.496, 2.546, 4.141/a7.0, 4.14-M, 4.15-M, 4.178, 4.179, 4.181, 4.189, 4.193, 4.20, 4.26, 4.28, 4.37, 4.45, 4.63, An te ndryshme, Pj te ndryshme.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |                                   |          |
| <b>NS - 4</b>                              | <b>Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | <b>2,550,047.51</b>               | <b>A</b> |
| Zerat e punes sipas kategorise se Liçenses | Punime rifiniture të muraturës: Ndërtimi, mirëmbajtja ose rristurimi i mureve ndarëse të çfarëdo lloji. Suvatime (të brendshme dhe të jashtme), patinime dhe bojatisje. Punime të ngjashme dekorative dhe teknike mbi sipërfaqet e muraturës. Punime me materiale druri, plastike dhe metalike: Karpenteri: Vendorsja, mirëmbajtja dhe rristurimi i punimeve prej druri. Dyer dhe dritare: Montimi i tyre për mjedise të brendshme dhe të jashtme. Veshje dysHEMEJE: Shtrimi i dysHEMEVE me materiale të ndryshme (dru, plastikë, etj.). Rifinitura teknike: Punime të realizuara me dorë apo me mjete, duke përdorur material plastik, xhami, metal ose materiale të ngjashme.                                                                            |                                   |          |
| Zerat e punes sipas preventivit            | 2.111, 2.197, 2.197/1, 2.200, 2.206, 2.209, 2.212, 2.300, 2.310, 2.331, 2.401, 2.404, 2.426/11, 2.428, 2.451, 2.576/2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                   |          |

**2.3.3** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në liçensën e

shoqërisë dhe të deklarojnë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Librezë pune (përkatëse)
- ii. CV (përkatëse)
- iii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- iiii. Diplome (përkatëse)

---

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehësuar me origjinalin).*

**Argumentimi :** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (I ndryshuar) dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(I ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve.

Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

VKM Nr.42 datë:16.1.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”-kreu IV, pika 1/a dhe ligjit nr.8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(I ndryshuar),neni 8 ku citohet:

Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore."

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.

Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane.

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Ndertimi

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- i. Librezë pune (përkatëse)
- ii. CV ( përkatëse )
- iii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- iiii. Diplome (përkatëse)

---

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehësuar me origjinalin).*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve.

Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Në lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Për sa më sipër, është e nevojshme që Operatorët ekonomikë të pasqyrojnë referenca të përshtatshme nga kontratat të zbatuara në të shkuarën nga ana e tyre.

- Inxhinieri i Ndërtimit : në mënyrë të përgjithshme është përgjegjës për punimet civile që kanë të bëjnë me betonimet e shtyllave, bazamentet e kabinave, rikthimet e rrugëve, të linjave TM/TU në objekt, duke siguruar zbatimin e kushteve të sigurisë, kabllit, kordinatat e kabinave, azhurnimin e gjurmës dhe kontrollon përputhjen e punimeve.
- Inxhinieri Elektrik : është përgjegjës për zbatimin e projektit të miratuar, sipas kushteve teknike për punime në linja dhe kabina elektrike përcaktuar sipas Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e duhur për të dëshmuar që ka përmbushur këtë kriter. Ky dokumentacion përfshin kontratën individuale të punës, diplomën perkatese e inxhinierave, CV, librezë pune dhe liste pagesa.

### **2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë *minimumi*:**

- a. 5 (pese) elektrikistë, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik minimumi me grupin II të vlefshme, nga të cilët minimumi 2 (dy) të jenë elektrikistë me grupin e sigurimit teknik IV të vlefshme, të leshuar nga shoqëria të akredituara në bazë të *Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike", i ndryshuar (Ligji nr.65/2012)*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Listë pagesat e punonjësve të sipërcituar të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin** e fundit të *deklaruar duke përfshirë listë pagesën e muajit të fundit*, si dhe
  - Kartelat perkatese të vlefshme të sigurimit teknik
- b. 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e *ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010*

*"Për sigurinë dhe shëndetin në punë" i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010*  
*"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" i ndryshuar*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata e cituar më sipër, kontratë pune e vlefshme, Librezë pune
  
- c. 1 (nje) manovrator te pajisur me karte personale te sigurimit teknik, te leshuar nga organet kompetente, i cili duhet te jete i siguruar te pakten per muajin e fundit te deklaruar *duke perfshire listepagesen e muajit te fundit (nese eshte i punësuar pranë operatorit ekonomik ofertues).*

*Ne rastin kur automjetet merren me qira, manovratori i pajisur me karte personale te sigurimit teknik, mund te kontraktohet nga OE ofertues per realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi.*

*Ne lidhje me manovratorin e makinerive te renda te paraqiten deshmite e drejtimit te leshuar nga organet perkatese.*

- d. 1(nje) shofer i cili duhet te jete i siguruar te pakten per muajin e fundit te deklaruar *duke perfshire listepagesen e muajit te fundit (nese automjetet jane ne pronesi te OE ofertues).*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale te vlefshme (leshuar nga institucionet perkatese), Librezë pune .

*(Në rastin kur punonjësi /shofer eshte kontraktuar me kontratë pune/sherbimi (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojë në listpagesat e shoqërisë) dhe duhet te paraqese:*

- kontratat e shërbimit/marrëveshjet e tjera kontraktore të ligjshme

**dh.** 4 (kater) punetore krahu te cilet duhet te jene te siguruar te pakten per muajin e fundit te deklaruar *duke perfshire listepagesen e muajit te fundit nese janë të punësuar pranë operatorit ekonomik ofertues.*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme,

*(Në rastin kur punonjësit janë kontraktuar me kontratë pune/shërbimi, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë) dhe duhet të paraqesë*

- kontratat e shërbimit/marrëveshjet e tjera kontraktore të ligjshme,

**e.** 2 (dy) muratorë, të cilët duhet të jenë të siguruar të pakten për muajin e fundit të deklaruar duke përfshirë listëpagesën e muajit të fundit (nese janë të punësuar pranë operatorit ekonomik ofertues).

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- kontratat e punës e vlefshme

*(Në rastin kur punonjësit janë kontraktuar me kontratë pune/shërbimi, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë) dhe duhet të paraqesin:*

- kontratat e shërbimit/marrëveshjet e tjera kontraktore të ligjshme

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehësuar me origjinalin.

**Argumentimi:** Kërkesa është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Perveç stafit Drejtues – Teknik dhe perkatesisht:

- Ing. Elektrik 1
- Ing. Ndertimi 1

Ne kërkesat e saj Njesia e Prokurimit me qëllim ecurine normale te punimeve dhe perfundimit ne afatin e kerkuar e bazuar ne zerat e preventivit si dhe ne manualin e-albania, kerkon nga Subjekti staf punonjes si me poshte:

### **1. Staf per Punime elektrike.**

Bazuar ne zerat e preventivit dhe sipas oreve te punes nxjerre nga manuali i e-albania per punimet elektrike rezulton se ne total punime elektike ne te cilat nevojitet nderhyrja dhe puna e personelit te specializuar elektriçiste, rezulton se per periudhen 9 mujore ne te cilen ky objekt duhet te perfundoje, jane ne total 10 512.04 ore pune elektike per te cilat nevojiten minimum 5 elektriçiste nga te cilet 2 duhet te jene me grupin 4 ST te sigurimit.

### **2. Staf per Punime dhe germime me krahe.**

Bazuar ne zerat e preventivit dhe sipas oreve te punes nxjerre nga manuali i e-albanias per punime germimi apo te ndryshme me krahe, rezulton se ne total punime per te cilat nevojitet puna e nje personelit te pa specializuar ( punetore krahu ), rezulton se per periudhen 9 mujore ne te cilen ky objekt duhet te perfundoje jane ne total 5 366.39 ore pune punime + germime me krahe, per te cilet duhen minimum 4 punetore te pa specializuar.

### **3. Staf per Punime civile ( muratore ).**

Bazuar ne zerat e preventivit dhe sipas oreve te punes nxjerre nga manuali i e-albanias per punime civile murature, rezulton se ne total punime per te cilat nevojitet puna e nje personelit muratore, rezulton se per periudhen 9 mujore ne te cilen ky objekt duhet te perfundoje jane ne total 1 764 ore pune punime murature dhe rifiniture, per te cilat duhen minimum 2 muratore.

### **4. Staf per Transport me Mjete transporti vetshkarkuese auto vinç 5 – 10 ton.**

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 4.167 ( *Transport materiale elektrike me kamion me vinc 5 - 10 ton deri 20 km* ) dhe bazuar ne oret dhe volume e punes per periudhen 9 mujore nevojiten minimum 1 shofer.

### **1. Staf per Germime & Shtrime te ndryshme me makineri Eskavator.**

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 3.89/a , 3.89/a etj ( *Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet* ) dhe bazuar ne oret dhe volume e punes per periudhen 9 mujore nevojitet minimum 1 manovrator.

Kërkesa për 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" për mbështetjen në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

**1.1.1** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 15** (pesëmbëdhjetë) **persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **muajin** e fundit të deklaruar *duke përfshirë listepagesen e muajit të fundit*
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për **muajin** e fundit të deklaruar *duke përfshirë listepagesen e muajit të fundit*, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehësuar me origjinalin).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

**Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.**

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit si dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit duke përfshirë ketu numrin total të punonjësve (inxhinierë, teknike, specialiste, punonjes të kualifikuar dhe punetore për punime me krahe, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të renda etj).

Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te jane bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

| Nr. | Mjetet/ makineri dhe pajisje                | Sasia  |
|-----|---------------------------------------------|--------|
| 1   | Eskavator me goma(makineri shtrimi&germimi) | 1cope  |
| 2   | Kenotron kablli                             | 1 cope |
| 3   | Tokmak elektrik                             | 1 cope |
| 4   | Betoniere (kantieri)                        | 1 cope |
| 5   | Prerese asfalti & betoni                    | 1 cope |
| 6   | Rul me goma                                 | 1cope  |
| 7   | Auto – vinç min 5-10 ton                    | 1 cope |

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton pronesine e mjetit (certifikate pronesie), dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi); te vlefshme. Per mjetet e siguruara me qera, te paraqiten dokumentet qe vertetojne rregjistrimin e tij, plus certifikaten e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit te vlefshme. Keto dokumente duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerases te vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes / fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit.

Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Per pajisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt shoqeruar me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesemarres duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesemarres duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve

të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

### **Argumentimet teknike të detajuara për numrin makineri & pajisje.**

Ne kërkesat e Njesia e Prokurimit ne kemi kërkuar që Subjekti të ketë gjithashtu dhe minimum makineri & pajisje si më poshtë, bazuar këto në zerat e preventivit si dhe në manualin e-albania:

#### **1. Eskavator me goma.**

Kerkohet në preventiv dhe në manualin e-albania është me kodin 3.89/a etj ( *Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjëresi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet* ) dhe bazuar në orët dhe vëllime të punës për periudhën 9 mujore nevojitet minimum 1 mjet Eskavator me goma.

#### **2. Mjete transporti vetshkarkuese auto vënc 5 – 10 ton.**

Kerkohet në preventiv dhe në manualin e-albania është me kodin 4.167 ( *Transport materiale elektrike me kamion me vënc 5 - 10 ton deri 20 km* ) dhe bazuar në orët dhe vëllime të punës për periudhën 9 mujore nevojiten minimum 1 mjet transporti vetshkarkuese auto vënc 5 – 10 ton.

#### **3. Rul me goma.**

Kerkohet në preventiv dhe në manualin e-albania është me kodin 3.209 ( *Shtresë çakelli mbeturinë kave t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri* ) dhe bazuar në orët dhe vëllime të punës për periudhën 9 mujore nevojiten minimum 1 Rul me goma.

#### **4. Tokmak Elektrik.**

Kerkohet në preventiv dhe në manualin e-albania është me kodin 2.19a ( *Hedhje, rrafshim, mbushje dhe me krah, kategoria IV* ) dhe bazuar në orët dhe vëllime të punës për periudhën 9 mujore nevojiten minimum 1 Tokmak elektrik.

#### **5. Prerese asfalti.**

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 4.190 ( *Prerje asfalti me disk, ne te dy anet.* ) dhe bazuar ne oret dhe volume e punes per periudhen 9 mujore nevojiten minimum 1 Prerese asfalti.

## **6. Betoniere kantieri.**

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 2.262 / 3 ( *Shtrese betoni C 12/15* ) dhe bazuar ne oret dhe volume e punes per periudhen 9 mujore nevojiten minimum 1 betoniere kantieri.

## **7. Kenotron kablli.**

Kerkohet ne preventiv dhe ne manualin e-albania eshte me kodin 4.189 ( *Kenotronim i kokave te kabllit per seksion (25 ÷ 240) mm<sup>2</sup>, tension 24 kV* ) dhe bazuar ne oret dhe volume e punes per periudhen 9 mujore nevojiten minimum 1 Kenotron kablli.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **9 (nente)** muaj kalendarike.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçense te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

*Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kusht **duhet të përmbushet nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehësuar me origjinalin).

**Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, ku parashikohet se: "leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet perkatese të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji".

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria "Menaxhimi i mbetjeve".

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, parashikohet se: "Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", pas miratimit të saj nga ministri".

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta": "Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme". Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi.

Kërkesa për licencën siguron që punët do të kryhen në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore. Licenca është e rëndësishme për të garantuar që operatori ekonomik do të menaxhojë mbetjet në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme. Kjo përfshin grumbullimin, transportimin dhe eliminimin e mbetjeve në mënyrë që të minimizohet ndikimi negativ mbi mjedisin dhe shëndetin e njerëzve.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat perkatese të vlefshme të ISO-ve, të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si me poshte:

ISO 9001: **e përditësuar** për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente (të vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

ISO 14001: **e përditësuar** për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ose ekuivalente (te vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

ISO 45001: **e përditësuar** për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë ose ekuivalente (te vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

\*\*\* Në rast bashkimi të operatoreve ekonomike, secili anëtar duhet të paraqesë certifikatën ISO në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

**Shënim:** Për certifikatat e mësipërme Operatorët Ekonomikë ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon këto certifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto certifikata janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të Ligjit 162/2020 të Prokurimit Publik, i ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

#### **Konkretisht:**

- Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE I interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 45001:2023 ose ekuivalent, është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, AK duhet të sigurohet se OE zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Paisja me këtë lloj certifikimi dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.
- Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 14001:2026 ose ekuivalent , pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

#### 2.4.2 Per listen e meposhtme te mallrave:

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- Cele TM 20kV sipas specifikimeve teknike
  - Muftje 20kV sipas specifikimeve teknike
  - Koka kablli TM 20kV sipas specifikimeve teknike
  - Kabell 20kV sipas specifikimeve teknike
  - Tuba PVC sipas specifikimeve teknike
  - Transformatore shperndarje sipas specifikimeve teknike
  - Pajisje dhe materiale sipas specifikimeve teknike
- a) Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.
  - b) Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit, per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe.  
Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogut, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.
  - c) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera, **test raportet**, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

## **ARGUMENTIM:**

**1.** Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së mallit të sipercituar.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plote të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

**2.** Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Gjithashtu kriteri për përkthimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e bleresit. Përkthimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mallrave. Kjo ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

**3.** Kjo kerkese ne lidhje me testimet zyrtare eshte ne perputhje me piken 6/c, te nenit 40 te VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Së pari, paraqitja e deshmive të testeve zyrtare siguron një burim të besueshëm të informacionit për cilësinë e mallrave. Testimet zyrtare janë kryer nga institucione të pavarura dhe të autorizuar ose nga prodhuesi i vetë mallrave, duke garantuar pavarësinë dhe besueshmërinë e rezultateve. Ky informacion është i rëndësishëm për AK për të siguruar që mallrat janë të pajtueshme me specifikimet dhe standartet e kërkuara.

Së dyti, kriteri për deshmitë e testeve zyrtare ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve. Duke përdorur informacionin e testeve zyrtare, AK mund të identifikojë përparësitë dhe mangësitë e çdo oferte potenciale. Duke kërkuar paraqitjen e deshmive të testeve zyrtare, AK mund të sigurojë që të gjithë operatorët ekonomikë kanë një mundësi të barabartë për të demonstruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të tyre. Kjo nxit konkurrencën e drejtë dhe siguron që oferta më cilësore të fitojë kontratën.

**4.** Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.4.3** Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetedeklarim qe deklaron se sistemi i menaxhimit te cilesise te prodhuesit / ve eshte sipas standartit ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara.

**Argumentim:** Kërkesa në lidhje është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ne lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të paraqesë vetedeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësive të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001 dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kerkuara, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

\*\*\*

Sjellim në vëmendje se bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehësuar me origjinalin.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose*

*originë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuesë, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.**

Specifikimet teknike janë hartuar nga OSSH qëndrojnë dërguar me e-mail në Drejtorinë Rajonale të Tiranës e OSSH sh.a.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.